

VENDIM
Nr. 48, datë 1.2.2023

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “NDËRTIMI I LINJËS 110 kV LIBRAZH-D-PËRRENJAS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i linjës 110 kV Librazhd-Përrenjas”.

2. Shpronësimi bëhet në favor shtetit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë” dhe “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 193 179 (njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 193 179 (njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekësh, përballohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.

8. Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë në favor të shtetit në përgjegjësi administrimi të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., të pasurive që shpronësohen, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Librazhd, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Librazhd, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, E TË CILËVE PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT
“RIKONSTRUKSIONI I LINJËS 110 kV LIBRAZHD–PËRRENJAS”

NR. Rendor	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKORE												VLERËSIMET PËR SHIPRONËSIM										Shënime	ADRESA:
																"ARË"				"TRUALL"				VLERA TOTALE (lekë)			
	Emri	Afësia	Mbiemri	Pshja e qortit N	C Z Kadastral	D Ne A pasq. rae	E Lajji pasq. rae	F Sipërfaqja Totale	G Ad (m2)	H Tër si dhe	I Nd er es	J Wdu an	K Baqe	L Sipërfaqja (m2)	M Pn t at	N Urta (k.m.)	O Sipërfaqja (m2)	P Pd nt at	Q Urta (k.m.)	Y							
	A	B	C	C Qortit N	C Z Kadastral	D Ne A pasq. rae	E Lajji pasq. rae	F Sipërfaqja Totale	G Ad (m2)	H Tër si dhe	I Nd er es	J Wdu an	K Baqe	L Sipërfaqja (m2)	M Pn t at	N Urta (k.m.)	O Sipërfaqja (m2)	P Pd nt at	Q Urta (k.m.)	Y		Z					
1	Lufti	Zeqr	Mojisa	LIBRAZH D QENDER	2448	317 / 2	Arc	4563	4563					42.45	174	7386				7386	Konfirmuar nga ASHK	Fshati: Librazhd Qender, NJ A-Qender Librazhd , Bashkia Librazhd					
2	Rexhep	Xhemal	Bici	DRAGOSTUNJE	1527	11 / 2	Arc	5200	5200					68.77	174	11966				11966	Konfirmuar nga ASHK	Fshati: Dradostunje, NJ A-Qender Librazhd , Bashkia Librazhd					
3	Harun	Ismail	Kaca	DRAGOSTUNJE	1527	24 / 20	Arc	4000	4000					38.88	174	6765				6765	Konfirmuar nga ASHK	Fshati: Dradostunje, NJ A-Qender Librazhd , Bashkia Librazhd					
4	Ali	Haziz	Bici	DRAGOSTUNJE	1527	24 / 3	Arc	880	880					54.24	174	9438				9438	Konfirmuar nga ASHK	Fshati: Dradostunje, NJ A-Qender Librazhd , Bashkia Librazhd					
5	Ymer	Sadi	Gurra	DRAGOSTUNJE	1527	294 / 7	Arc	4200	4200					51.77	174	9008				9008	Konfirmuar nga ASHK	Fshati: Dradostunje, NJ A-Qender Librazhd , Bashkia Librazhd					
6	Daut	Ali	Barthoshi	DRAGOSTUNJE	1527	658 / 3	Arc	2600	2600					51.77	174	9008				9008	Konfirmuar nga ASHK	Fshati: Dradostunje, NJ A-Qender Librazhd , Bashkia Librazhd					
7	Murat	Estref	Alliu	HOTOLISHT	1967	460 / 1	Arc	1300	1300					6.3	174	1096				1096	Konfirmuar nga ASHK	Fshati: Hotolisht, NJ A: Hotolisht , Bashkia Librazhd					
8	Ali	Ibrahim	Çota	HOTOLISHT	1967	553 / 4	Arc	1173	1173					72.81	174	12669				12669	Konfirmuar nga ASHK	Fshati: Hotolisht, NJ A: Hotolisht , Bashkia Librazhd					
9	Halim	Qamil	Nogu	HOTOLISHT	1967	570	Arc	1400	1400					51.77	174	9008				9008	Konfirmuar nga ASHK	Fshati: Hotolisht, NJ A: Hotolisht , Bashkia Librazhd					
10	Sabri	Osman	Meralla	VULÇAN	3843	433 / 2	Arc	6010	6010					34.05	174	5925				5925	Konfirmuar nga ASHK	Fshati: Vulçan, NJ A: Hotolisht , Bashkia Librazhd					
11	Veli	Reshit	Qeku	VULÇAN	3843	469 / 17	Truall	300	0	300	80						105.6	154	16256	16256	Konfirmuar nga ASHK	Fshati: Vulçan, NJ A: Hotolisht , Bashkia Librazhd					
12	Lufti Ramadan Loshi, Leonard L.Loshi, Sadete L.Shyti, L.Krevcmadhj,	Xhevahir Lufti Loshi, Rajmonda Miranda L.Hasanllari		QUKËS SHIKUMBIN	3120	124 / 1	Arc	1500	1500					90.12	174	15681				15681	Konfirmuar nga ASHK	Fshati: Qukes Shikumbin, NJ A: Qukes , Bashkia Prcenjas					
13	Pasho	Qamil	Kopaci	QUKËS SHIKUMBIN	3120	259 / 11	Arc	3000	3000					36.58	174	6365				6365	Konfirmuar nga ASHK	Fshati: Qukes Shikumbin, NJ A: Qukes , Bashkia Prcenjas					
14	Nazmi	Avdyll	Haxhiu	QUKËS SHIKUMBIN	3120	303 / 56	Arc+ Truall	17300	17000	300	112			50.87	174	8851				8851	Konfirmuar nga ASHK	Fshati: Qukes Shikumbin, NJ A: Qukes , Bashkia Prcenjas					
15	Selami		Alliu	QUKËS SHIKUMBIN	3120	303 / 43	Arc	2844	2844					64.85	174	11284				11284	Konfirmuar nga ASHK	Fshati: Qukes Shikumbin, NJ A: Qukes , Bashkia Prcenjas					
16	Muhamet	Zeqr	Çela	SKROSKE	3468	671 / 9	Arc	6000	6000					31.85	174	5542				5542	Konfirmuar nga ASHK	Fshati:Skroske, NJ A: Qukes , Bashkia Prcenjas					
17	Halim	Sabri	Belba	SKROSKE	3468	651	Arc	4500	4500					57.35	174	9979				9979	Konfirmuar nga ASHK	Fshati:Skroske, NJ A: Qukes , Bashkia Prcenjas					
18	Halim	Sabri	Belba	SKROSKE	3468	650 / 2	Arc	5725	5725					72.81	174	12669				12669	Konfirmuar nga ASHK	Fshati:Skroske, NJ A: Qukes , Bashkia Prcenjas					
19	Qani	Rustem	Mekshi	PISHKASH VERRI	2970	380	Arc	884	884					57.35	174	9979				9979	Konfirmuar nga ASHK	Fshati:Pishkash Verr, NJ A: Qukes , Bashkia Prcenjas					
20	Adem	Mehmet	Gula	PISHKASH VERRI	2970	571	Arc	1006	1006					42.45	174	7386				7386	Konfirmuar nga ASHK	Fshati:Pishkash Verr, NJ A: Qukes , Bashkia Prcenjas					
21	Bedri	Selim	Komici	PISHKASH VERRI	2970	1102	Arc	4133	4133					29.29	174	5096				5096	Konfirmuar nga ASHK	Fshati:Pishkash Verr, NJ A: Qukes , Bashkia Prcenjas					
22	Seit	Dilo	Mekshi	PISHKASH VERRI	2970	804	Arc	5920	5920					10.47	174	1822				1822	Konfirmuar nga ASHK	Fshati:Pishkash Verr, NJ A: Qukes , Bashkia Prcenjas					
	SHUMA																			193179							